Gjenerata Z në botën digjitale

Kush kë e fitoi ?

Autor: Monika Veljanoska

- “A mund të më thoni ju lutem, cilën rrugë të marr prej këtu ?” pyeti Alisa.
- “Kjo varet prej asaj se ku dëshiron të shkosh?”- tha macja.
- “Nuk ka rëndësi se ku shkoj ” u përgjigj Liza.
- “Atëherë” tha macja, “nuk ka rëndësi se cilën rrugë merr.”

Luis Keroll (Lewis Carroll), me librin e tij të përbotshëm “ Liza në botën e çudirave”, me folklorin dhe fantazinë e pasur, ka qenë objekt i analizave, interpretimeve, teatrit dhe filmit profesional si dhe shkollor për më shumë se një shekull. Loja e gjallë e imagjinatës dhe qasja depërtuese për të paraqitur personazhin dhe jetën e përditshme të Lizës dhe personazhëve tjerë, të kujton përditshmërinë e sotme. Ky tekst nuk ka ndërmend të merret me analizën dhe interpretimin e librit, por dialogu midis Lizës dhe maces, më saktë konfuzionit të saj, më bëri që të përpiqem të paraqes jetën e përditshme të rinisë së sotme në botën digjitale.

Liza, si një përfaqësuese shumë e zakonshme e brezit të saj, në këtë tekst është protagonistja kryesore, e cila për këtë nevojë është 17 vjeçare, është një nxënëse solide dhe jeton me prindërit e saj. Familja e saj i përket klasës së mesme. Ajo shpenzon më shumë se 5 orë në “smartphonin” e saj dhe ka profile në të gjitha rrjetet sociale. Ndër gjërat që lexon më shpesh janë: postimet e miqve, sheh video, shou biznes dhe po, nuk i kujtohet se cilat revista, gazeta apo portale ka “pëlqyer”. Liza do të jetë një e rritur me të drejtën e votës vitin e ardhshëm, kështu që unë jam duke menduar me zë të lartë se si ajo do ta bënte zgjedhjen për të votuar, ose se si po informohet tani në kohën e krizës shëndetësore, për të cilën thotë se po ndodh në shoqëri. Liza, si qenie politike, duhej (të ishte mësuar) të marr iniciativa, përgjegjësi dhe angazhim shoqëror. Ajo lufton qetësisht me sistemin, herë-herë fiton forcë, herë-herë ajo është e qetë dhe injorohet nga më të rriturit.

Në studimin "Hartimi i niveleve për njohje mediale në Republikën e Maqedonisë së Veriut te grupmoshat mbi 16 vjet - 2019"[1],, të rinjtë, ndryshe nga më të rriturit, kanë më shumë aftësi digjitale, por kanë mungesë të aftësive në funksionim. Çdo i treti nga të rinjtë e moshës 16 vjeç përdor lajmet e transmetuara në televizion si burim informacioni, ndërsa më shumë se gjysma e tyre informohen nga njoftimet dhe komentet në rrjetet sociale. Ky fakt është edhe më shqetësues nëse i shtojmë konkluzionet e hulumtimit "Mendimi kritik dhe mënyrat e informimit të rinisë"[2] që tregon se studentët e rinj nuk janë

[1]https://mediumskapismenost.mk
[2] https://crithink.mk/e-biblioteka/

të përgatitur sa duhet për mendim kritik.

Në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë Liza, me 17 vjetët e saj i vetmi fajtor për pozicionin e tyre të margjinalizuar në shoqëri, por produkti i kësaj kohe, në të cilin prindërit nuk kanë shumë kohë për ta, mësuesit janë në një garë me ditarin elektronik, media vendase (TV- të, radiot dhe portalet elektronike) nuk prodhojnë asnjë program që do të tërhiqte vëmendjen e të rinjve. Nëse shkojmë një hap më tej, në analizimin e rezultateve të hulumtimit, atëherë duhet të theksohet se media është e njëtrajtshme për të rinjtë, ata informojnë për të njëjtat ngjarje, dhe ata u besojnë më së paku televizioneve dhe portaleve informative. Më shumë se gjysma e 16-vjeçarëve i konsiderojnë portalet me ngjyra politike, dhe se nëpër rrjetet sociale shpesh postohen "lajme të rreme"

Tani, kush kë fiton?

Liza, e cila shmang mediat vendase, sepse ajo i percepton ato si zëdhënëse të partive politike që atë nuk e fusin në kandar dhe as e respektojnë pozicionin e saj, ose mediat që luajnë "vijën e ulët të rezistencës" në hartë, d.m.th. nuk ndryshojnë. Nëse Lizën nuk e shikojmë si një vajzë të painteresuar, por si një vajzë të indinjuar, atëherë mund ta kuptojmë interesin e saj injorant për mediat, kështu që, në ora 5 pas shkollës ajo sheh një film serial skllavërues me skena të dhunshme, apo emision debatues me fytyrat e njejta, kryesisht pensionistë, apo emisione politike ku të ftuar të shpeshtë janë të gjithëdijshmit (politikanë dhe analistë) që kanë ekspertiza në politikën e jashtme, transparencën, urbanizmin dhe për të zotëruar teoritë e komplotit.

Liza është pjesë e gjeneratës Z[3] e cila aktualisht është gjenerata më e avancuar në teknologji dhe është shumë e ekspozuar ndaj mediave digjitale dhe rrjeteve sociale. Sipas udhëzimeve të saj psikologjike dhe sociologjike, karakteristikat e kësaj gjenerate janë; mendje e hapur, mendim gjithëpërfshirës dhe pa paragjykime ndaj të tjerëve. Derisa sektori i biznesit ndjek karakteristikat, vlerat dhe tendencat e gjeneratës Z, në mënyrë që të zhvillojë statistika të hollësishme, fakte dhe strategji të marketingut që synojnë këtë gjeneratë, sepse së shpejti do të bëhet grupi më i madh i konsumatorëve, mediat tona (TV shtetërore, madje edhe portalet) nuk e kanë haberin se si ta përfshijnë popullsinë e re.

Kjo gjeneratë, ku më të rriturit janë studentët, është më e ekspozuar ndaj manipulimeve të rrjeteve sociale, dhe arsimimi nuk është i gatshëm të merret me barrën e zhvillimit të teknologjisë, aftësive digjitale dhe nevojat e të rinjve. Si duket rritja e kësaj gjenerate është më e vështirë se e çdo gjenerate tjetër, imazhet për veten e tyre i formojnë nën presionin e Fejsbukut dhe Instagramit, duke pritur "pëlqime" nga miqtë ose nga videoja e influenceres me të cilët identifikohen. Kjo gjeneratë, megjithëse më e gatshme për të menaxhuar mjetet digjitale, është më e goditura, kështu që i gjithë sistemi, arsimi

[3] Emërtim popullor I atyre që kanë lindur ndërmjet viteve 1996 -2010.

zyrtar dhe joformal, media dhe prindërit duhet ta vendosin botën virtuale në shërbim të zhvillimit të shëndetshëm të gjeneratës Z dhe ta përgatisin atë për të parë në mënyrë kritike informacionin e publikuar, në media, qoftë tradicionale apo elektronike.

E dashur Liza, përdore me mençuri telefonin tënd të zgjuar!